Nr. 988/2 prot. Tiranë, më 14.08.2026

VENDIM

Nr. 31, datë 14.08.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve "Albautor" (në vijim "ankuesi") ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") formularin e ankesës nr. 988 prot., datë 07.04.2026, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 09.02.2026, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

- *Procesverbalin e inspektimit si dhe Vendimin përfundimtar të inspektimit për secilin prej 87 subjekteve, për të cilët nuk është marrë masë administrative gjatë inspektimeve të kryera në vitin 2023.*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 851/1 prot., datë 17.02.2026, ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion, duke sqaruar se: *"...ISHMT-ja i është përgjigjur kërkesës për informacion nëpërmjet takimit të datës 15.04.2025, shkresës nr. 1825/1 prot., datë 12.05.2025, e-mail-it datë 11.07.2025, shkresës nr. 3375/1 prot., datë 19.08.2025. Në të gjitha format e përgjigjes ju është sqaruar se informacioni është dhënë në përputhje me parashikimet ligjore (ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"), për sa i përket të dhënave konfidenciale të institucionit. Si rrjedhojë,*

informacioni që ju keni kërkuar me shkresën nr. 167 prot., datë 09.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 851 prot., datë 10.02.2026, nuk mund t'ju vihet në dispozicion."

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, me shkresën nr. 988/1 prot., datë 19.05.2026, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 22.05.2026.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 851/3 prot., datë 25.05.2026, ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: *"ISHMT e vlerëson informacionin konfidencial bazuar në nenet 8 dhe 9 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Proceduarve Administrative i Republikës së Shqipërisë", nenin 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar, nenin 10 të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Urdhrit nr.273, datë 27.02.2025, të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut" dhe si rrjedhojë nuk mund t'ia ofrojë subjektit ankues informacionin e kërkuar."*

Pas përgjigjes së sipërcituar, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: "*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", bazuar edhe në nenin 87 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore, e cila u zhvillua më datë 07.07.2026, me praninë e përfaqësuesve të Autoritetit Publik dhe ankuesit.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesën fillestare, si dhe vijimin e saj. Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur në aktet shkresore të sipërcituara, si dhe depozituan pretendimet e tyre me shkresën nr. 3009/4 prot., datë 06.07.2026, duke u shprehur ndër të tjera se: *"...AAK "Albautor" nuk është në cilësinë e palës ankuese (sipas nenit 45 ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"), që të ketë të drejtën e pajisjes me kopjen e praktikës së inspektimit. Procedurat e inspektimit nuk*

janë realizuar në bazë të ndonjë ankese të paraqitur nga ky subjekt kundrejt një subjekti tjetër në lidhje me një vepër konkrete që agjencia mbron. Në përgjigjet e ISHMT-së, ndër të tjera, është sqaruar që kopja e praktikës, përveç palës ankuese specifike (sipas ligjit të cituar në këtë paragraf), mund t'i jepet vetëm organit hetimor në rast të një hetimi për çështje penale. Dhënia e kopjes së praktikave përtej parashikimeve ligjore do të përbënte një precedent negativ për institucionin tonë, si dhe mbi të gjitha nuk do të ndikonte në mbrojtjen e asnjë të drejte të parashikuar nga legjislacioni në fuqi". Në vijim të diskutimit të palëve gjatë seancës dhe referencave ligjore të cituara nga drejtuesi i seancës, përfaqësuesve të Autoritetit Publik iu la kohë në dispozicion për të rivlerësuar qëndrimin e mbajtur ndaj kërkesës për informacion.

Pas seancës dëgjimore, me shkresën nr. 3009/7 prot., datë 16.07.2026, Autoriteti Publik sqaroi se: *"...Në mbështetje të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Proceduarve Administrative i Republikës së Shqipërisë", nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar, nenit 10 të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Urdhrit nr. 273, datë 27.02.2025, të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut", ISHMT i ka përcjellë subjektit AAK "Albautor" listën e subjekteve të cilët në momentin e inspektimit kanë paraqitur autorizimin nga SUADA ose mandatin e pagesës kundrejt SUADA-s (ndërkohë që kanë qenë në pritje të pajisjes me autorizim), si dhe subjektet të cilët e kanë paraqitur autorizimin e lëshuar nga SUADA pas lënies detyrë nga grupi i inspektimit. Çdo informacion tjetër i kërkuar nga subjekti në lidhje me procedurat e inspektimit të realizuara në vitin 2023, ISHMT e ka vlerësuar konfidencial dhe në mbrojtjen e të dhënave të subjekteve".*

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI-së.

Në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së parashikohet se: *""Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj"*. Në kuptim të këtij parashikimi, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI në nenin 1 përcakton se: *"1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike".*

Në argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për refuzimin e dhënies së informacionit të kërkuar se procesverbalet e inspektimit dhe vendimet përfundimtare nuk mund të vihen në dispozicion të kërkuesit për shkak se përmbajnë "të dhëna konfidenciale", Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk përbën në vetvete një bazë të mjaftueshme ligjore për refuzimin e së drejtës së informimit. Në rastin konkret, Autoriteti Publik është mbështetur në nenet 8 dhe 9 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në nenin 17 të LDI-së, si dhe në nenin 10 të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Këto dispozita, të marra së bashku, nuk krijojnë një regjim të përgjithshëm konfidencialiteti mbi të gjithë dokumentacionin e procedurave të inspektimit.

Detyrimi për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe të të dhënave personale, tregtare ose profesionale duhet të harmonizohet me të drejtën e informimit dhe nuk mund të interpretohet si bazë për refuzimin e dokumentit në tërësi. Për të justifikuar kufizimin, autoriteti duhet të përcaktojë konkretisht se cilat të dhëna të dokumentit janë të mbrojtura, në bazë të cilës dispozitë ligjore gëzojnë këtë mbrojtje dhe përse dhënia e tyre do të cenonte interesin e mbrojtur.

Edhe neni 10 i ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i cili rregullon informimin e publikut dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në veprimtarinë inspektuese, nuk përcakton se procesverbalet, vendimet përfundimtare apo dokumentacioni tjetër i procedurave të inspektimit janë në tërësi konfidenciale. Kjo dispozitë kërkon që informimi i publikut të bëhet duke respektuar kufijtë e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale. Për rrjedhojë, ajo nuk mund të interpretohet si një ndalim i përgjithshëm për aksesin në dokumentacionin e inspektimit, por si një kërkesë për harmonizimin e transparencës me mbrojtjen e kategorive konkrete të informacionit që gëzojnë mbrojtje ligjore. Në këtë kuptim, qëllimi i ligjit të sipërcituar përfshin shprehimisht mbrojtjen e interesit publik, transparencën dhe llogaridhënien në veprimtaritë e inspektimit. Për këtë arsye, pas përfundimit të procedurës së inspektimit, ekziston një interes publik i ligjshëm për t'u njohur me mënyrën se si Autoriteti Publik ka ushtruar kompetencat e tij, me gjetjet e inspektimit dhe me vendimmarrjen e marrë në përfundim të tij.

Ndërkohë, referimi i Autoritetit Publik të Urdhrit nr. 273, datë 27.02.2025, të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut", nuk mund të konsiderohet si bazë autonome për kufizimin e së drejtës së informimit, nëse një kufizim i tillë nuk buron nga ligji. Një akt i brendshëm mund të përcaktojë rregulla për administrimin, ruajtjen dhe trajtimin e informacionit nga autoriteti, por nuk mund të zgjerojë rastet e kufizimit të së drejtës së informimit përtej atyre të parashikuara nga ligji.

Gjithashtu, vlen të theksohet se pretendimi i Autoritetit Publik duke u shprehur se: "*AAK "Albautor" nuk është në cilësinë e palës ankuese që të ketë të drejtën e pajisjes me kopjen e praktikës së inspektimit dhe se procedurat e inspektimit nuk janë realizuar në bazë të ndonjë ankese të paraqitur nga ky subjekt kundrejt një subjekti tjetër në lidhje me një*

vepër konkrete që agjencia mbron", nuk gjen mbështetje në ligj. Sipas pikës 1 të nenit 3 të LDI-së, parashikohet se: "*1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet*", ndërsa përkufizimi i termit "person" përcaktohet në pikën 3 të nenit 2, ku parashikohet se: *"3. "Person" është çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, si dhe personat pa shtetësi".* Asnjë prej këtyre dispozitave nuk parashikon ndonjë kufizim, cilësi të veçantë apo kusht që duhet të përmbushë ankuesi për marrjen e informacionit. Në vijim të këtyre parashikimeve, e drejta për informim nuk mund të refuzohet për shkak se ankuesi nuk ka cilësinë e palës ankuese.

I pabazuar në ligj është edhe pretendimi se *dhënia e kopjes së praktikave përtej parashikimeve ligjore do të përbënte një precedent negativ për institucionin, si dhe mbi të gjitha nuk do të ndikonte në mbrojtjen e asnjë të drejte të parashikuar nga legjislacioni në fuqi*. Përveçse nuk është paraqitur asnjë argument konkret mbi precedentin negativ eventual që mund të krijojë dhënia e informacionit, rezulton se ai në vetvete nuk përbën shkak për kufizimin e së drejtës për informim në përputhje me rastet e parashikuara nga LDI në nenin 17 të tij.

Po ashtu, bazuar në pikën 23 të nenit 5 të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale": *""Subjekt i të dhënave" është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror".* Në këtë kuadër, emrat e subjekteve të regjistruar si person fizik ose juridik në bazë të legjislacionit përkatës tregtar nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe, si të tilla, nuk gëzojnë mbrojtje nga ky ligj.

Në këto kushte, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të LDI-së, i cili përcakton se: *""Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".* Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar duke mbajtur në konsideratë pikën 6 të nenit 17 të LDI-së, sipas të cilit parashikohet se: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim"*.

Në përfundim, dokumentet e kërkuara, përfshirë procesverbalet e inspektimit dhe vendimet përfundimtare të procedurave të përfunduara, përbëjnë informacion publik dhe nuk rezulton të ketë një bazë ligjore që t'i konsiderojë ato, në tërësi dhe në mënyrë automatike, si informacion konfidencial. Nëse në përmbajtjen e tyre ndodhen të dhëna që gëzojnë mbrojtje ligjore, kufizimi duhet të zbatohet vetëm ndaj këtyre të dhënave dhe nuk mund të shtrihet në të gjithë dokumentin, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI-së.

Në përfundim, Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër joshtetëror, që ushtron funksione publike. Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI-së: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".*

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dyja palëve.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 988 prot., datë 07.04.2026, të Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve "Albautor" kundër Autoritetit Publik "Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 09.02.2026, konkretisht *Procesverbalin e inspektimit si dhe Vendimin përfundimtar të inspektimit për secilin prej 87 subjekteve, për të cilët nuk është marrë masë administrative gjatë inspektimeve të kryera në vitin 2023,* brenda datës 24.08.2026.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot, më datë 14.08.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi